

 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO		 KOMUNA E VUSHTRRIË OPSTINA VUCITRN MUNICIPALITY OF VUSHTRRI
--	--	--

Në mbështetje të nenit 12.2, shkronja c), dhe nenit 17 pika (c) Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 04.06.2008, nenit 15, shkronja a) të Ligjit nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 03.06.2008, dhe nenit 41, paragrafit 2, shkronja c) e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur me __.__.2026, e miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E VENDPARKIMEVE PUBLIKE NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

KREU I DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i zonave të vendparkimeve publike, rregullimi i kushteve për shfrytëzimin e tyre, mënyrat së pagesës, çmimet dhe llojet e biletave për parkim, si dhe përcaktimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit të parkimit të automjeteve në hapësirat publike të cilat janë nën pronësi të komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore do të zbatohet ndaj të gjithë personave të cilët do të shfrytëzojnë hapësirat publike të parkimit të cilat janë nën pronësinë e Komunës së Vushtrrisë, të cilat do të menaxhohen nga N.P.L “Përparimi” Sh. A në Vushtri.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1 Parkim** - nënkupton çdo ndërprerje e lëvizjes së mjetit në rrugë në kohëzgjatje më shumë se tre minuta.
- 1.2 Vend parkimet publike** - nënkupton hapësirën e dedikuar për parkimin e Veturave, e cila është e rregulluar si vendparkim dhe e shënuar me shenja të komunikacionit dhe me informata rreth zonës së parkimit.
- 1.3 Zona e parkimit** – nënkupton zonën në pjesë të caktuar të qytetit, në të cilën gjenden hapësirat publike të dedikuara për parkim.
- 1.4 Vetura** - nënkupton çdo mjet që lëviz në rrugë me fuqi të motorit të vet, i cili sipas konstruksionit, pajisjeve, veglave e pajimeve është paraparë për transport të personave.
- 1.5 Trotuar** - nënkupton sipërfaqja e rregulluar pranë rrugës posaçërisht për lëvizje të këmbësorëve, e cila nuk është në nivel me rrugën qarkulluese ose është e ndarë në mënyrë tjetër nga rruga.
- 1.6 Parkim me Laurë** – Nënkupton hapësirën e dedikuar për parkimin e automjeteve, në të cilën gjenden shumë vend-parkingje dhe që është e vendosur rampa (Laura) me të cilën u lejohet hyrja në vendparkime shfrytëzuesve.
- 1.7 Parkim për banorët rezidentë** – nënkupton vendparkimet të cilat gjenden përgjatë rrugës në të cilën janë afër ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, dhe që mundësinë e shfrytëzimit të këtij lloji të parkimit mund të bëhet vetëm nga banorët (pronar apo shfrytëzues) që jetojnë në ato ndërtesa.
- 1.8 Parkim i rezervuar për bizneset dhe OJQ-të** – nënkupton vendparkimet të cilat gjenden përgjatë rrugës në të cilën janë afër ndërtesat (lokalet për afarizëm apo shoqatave), dhe që shfrytëzimit të këtij lloji të parkimit bëhet vetëm nga veturat që i përkasin bizneseve apo ojq-ve.
- 1.9 Parkim i kohëpaskohshëm** – nënkupton shfrytëzimin e vendparkimeve brenda dite.
- 1.10 Parkim i përkohshëm** – nënkupton shfrytëzimin e vendparkimeve për një kohë të caktuar prej një (1) muaj.
- 1.11 Parkim i përhershëm** – nënkupton shfrytëzimin e vendparkimeve për një periudhë një (1) vjeçare, në bazë të marrëveshjes me Ndërmarrjen.

1.12 Tarifa Shtesë - përfaqëson vlerën e shërbimit të ofruar, shpenzimet e monitorimit dhe kostot administrative të përpunimit të shkeljes, dhe si e tillë trajtohet si detyrim civil i shfrytëzuesit ndaj Ndërmarrjes.

1.13 Kontrollori – Punëtor i ndërmarrjes, përgjegjës për pranimin e pagesës, dhe kontrollimit të rregullsisë së pagesës, dhe mënyrës së shfrytëzimit të vendparkimit.

1.14 Ndërmarrja - nënkupton N.P.L “Përparimi” Sh. A.

KREU II

VENDPARKIMET DHE LLOJET E TYRE

Neni 4

Vendparkimet publike

Vendparkimet publike janë të gjitha hapësirat të cilat janë të dedikuara për parkimin e veturave, të cilat janë nën pronësinë e komunës, dhe të cilat menaxhohen nga ndërmarrja.

Neni 5

Llojet e vendparkimeve publike

1. Klasifikimi i vendparkimeve publike realizohet duke u bazuar në dy kritere kryesore:
 - 1.1 Sipas mënyrës shfrytëzimit dhe destinimit të vendparkimeve publike;
 - 1.2 dhe në bazë të kohëzgjatjes së shfrytëzimit të vendparkimeve publike;
2. Ndarja e vendparkimeve publike në bazë të mënyrës së shfrytëzimit është si në vijim:
 - 2.1 Vendparkim me qasje të kontrolluar (Laurë).
 - 2.2 Vendparkim i rezervuar për banorët rezidentë;
 - 2.3 Vendparkim i rezervuar për bizneset dhe OJQ-të;
3. Ndarja e vendparkimeve në bazë të kohëzgjatjes së shfrytëzimit të tyre është si në vijim:
 - 3.1 Parkim i kohëpaskohshëm (me orë ose ditor).
 - 3.2 Parkim i përkohshëm (shfrytëzim afatmesëm apo mujor).
 - 3.3 Parkim i përhershëm (shfrytëzim afatgjatë vjetor e rregulluar me kontratë).

Neni 6

Ndarja e zonave të vendparkimeve publike

1. Bazuar në vendet ku shtrihen, ngarkesën e trafikut, kohëzgjatjen e lejuar dhe lartësisë së çmimit të parkimit, vendparkimet publike ndahen në tri (3) zona kryesore:
 - 1.1 Zona e parë (I) përfshin hapësirat e parkimit në rrugët si në vijim:
 - 1.1.1 Rr. Basri Beqiri (Te Komuna).
 - 1.1.2 Rr. Hasan Prishtina.

- 1.1.3 Si dhe të dy anët e rrugës Xhevat Jusufi.
- 1.2 Zona e dytë (II) përfshin hapësirat e parkimit në rrugët si në vijim:
 - 1.2.1 Rr. Dëshmorët e Kombit nga fillimi i rr. Burhan Badivuku deri tek fillimi i rr. Bedri Bajgora.
 - 1.2.2 Rr. Dëshmorët e Kombit ngjitur me Parkun e Qytetit (Taxitë),
 - 1.2.3 Rr. Ahmet Selaci.
 - 1.2.4 Si dhe Rr. Kruja.
- 1.3 Zona e tretë (III), përfshin hapësirat e parkimit në rrugët dhe vendet si në vijim:
 - 1.3.1 Rr. Gjergj Kastriot Skënderbeu.
 - 1.3.2 Rr. Vicianana.
 - 1.3.3 Si dhe dhe një pjesë e oborrit të muzeut.
2. Zonat e cekura në par. 1 të këtij neni, do të shfrytëzohen si në vijim:
 - 2.1 Zona e parë (I) i ka këto nën zona:
 - 2.1.1 Vendparkimet që gjenden në rr. Basri Beqiri (Te komuna), do të shfrytëzohen ekskluzivisht për parking të kohëpaskohshëm (me orë);
 - 2.1.2 Vend parkimet që gjenden në rr. Hasan Prishtina në të dy kahjet do të shfrytëzohen si parking i kohëpaskohshëm (me orë), por edhe si vend parkim i rezervuar për banorët rezident dhe bizneset/ojq-të;
 - 2.1.3 Vend parkimet që gjenden në të dy anët e rrugës Xhevat Jusufi., do të shfrytëzohen si vend parkim i rezervuar për banorët rezident dhe personat juridik, si parking i kohëpaskohshëm.
3. Zona e dytë (II) ka nën zonat tek Rr. Dëshmorët e Kombit, Fatime Hetemi, rr. Kruja, rr. Ahmet Selaci dhe Parkingu Nëntokësor do të shfrytëzohen në mënyrë përzier ku do të lejohet parkimi i kohëpaskohshëm (me orë), parkimi mujor (i përkohshëm) dhe parkimi i rezervuar (për banorë dhe biznese).
4. Zona e tretë (III), vendparkimet që gjenden tek rr. Gjergj Kastriot Skënderbeu, dhe rr. Vicianana, dhe një pjesë e oborrit të muzeut do të shfrytëzohen për parking të përhershëm të rezervuar për banorët rezident dhe bizneset/ojq-ve.

KREU III

RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E VENDPARKIMEVE PUBLIKE

Neni 7

Mekanizmat e kontrollit të vendparkiemve

1. Në vendparkime bëhet kontrollimi i rregullsisë së pagesës dhe respektimit të zonave.
2. Kontrollimi nga par. 1 i këtij neni, mund të bëhet si në vijim:
 - 2.1 Në vendparkimet me pagesë të menjëhershme (“Laurë”), kontrolli i hyrjes dhe daljes realizohet përmes sistemit automatik të rampës dhe pajisjes inkasuese.

- 2.2** Në vendparkimet e destinuara dhe të rezervuara për banorët rezidentë, si dhe për subjektet juridike (biznese dhe organizata joqeveritare), kontrolli i shfrytëzimit kryhet nga punëtorët e ndërmarrjes përmes verifikimit të targave të automjeteve.
- 2.3** Në vendparkimet e kohëpaskohshme, punëtorët e ndërmarrjes kryejnë kontrollin e vlefshmërisë së biletave përmes verifikimit vizual të tyre, të vendosura në pjesën e brendshme të xhamit të përparmë të automjetit.

Neni 8

Sinjalizimi i parkingjeve publike

- 1.** Vendparkimet publike duhet të jenë të pajisura me sinjalizim horizontal dhe vertikal, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullat e sigurisë në komunikacion.
- 2.** Përveç sinjalizimit të trafikut, vendparkimet publike duhet të kenë të shënuara në vend të dukshëm të dhënat përkatëse, si:
 - 2.1** Zonën e parkimit;
 - 2.2** Çmimin e parkimit;
 - 2.3** Kohëzgjatjen e lejuar të parkimit;
 - 2.4** Shenjat që tregojnë nëse vendparkimi është i rezervuar apo jo;
 - 2.5** Destinimin e përdorimit të vendparkimit;
 - 2.6** Njoftimin se pas kalimit të kohës së caktuar të paguar, do të aplikohet Tarifa Shtesë;
 - 2.7** Si dhe çdo shenjë tjetër të nevojshme për informimin e shfrytëzuesve.
- 3.** Dimensionet e vend parkimeve publike janë të përcaktuara me UA MMPH-08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor.

Neni 9

Rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i vendparkingjeve

- 1.** Ndërmarrja është e obliguar të rregullojë, mirëmbajë dhe të sinjalizojë vendparkimet publike.
- 2.** Mjetet financiare për kryerjen e punëve nga par. 1 i këtij neni, në vendparkime sigurohen nga të hyrat e inkasuara nga vendparkimet.

Neni 10

Vendparkimet për personat me nevoja të veçanta

Vendparkimet për personat me nevoja të veçanta, duhet të jenë të sinjalizuara dhe të njëjtat mund t'i shfrytëzojnë vetëm personat të cilët posedojnë dokumentacion, me të cilin dëshmohet se personi ka nevoja të veçanta.

KREU IV

TARIFAT DHE MËNYRAT E PAGESËS

Neni 11

Tarifa e shfrytëzimit të vendparkimeve

1. Për shfrytëzimin e vendparkimit, shfrytëzuesit janë të obliguar të paguajnë çmimin e parkimit e cila përcaktohet në bazë të:
 - 1.1 Kohëzgjatjes së shfrytëzimit të vend parkimit;
 - 1.2 Zonës në të cilën gjendet vend parkimi;
2. Tarifat të cilat duhet të paguhet sipas par. 1 të këtij neni janë të caktuara në kuadër të shtojcës së kësaj rregulloreje.
3. Me rastin e caktimit të tarifave, duhet të merren parasysh kriteret e mëposhtme:
 - 3.1 Mënyrën e shfrytëzimit të vendparkimeve.
 - 3.2 Kohëzgjatjen e vendparkimit.
 - 3.3 Zonën e parkimit.
 - 3.4 Mirëmbajtjen e vendparkimeve.
 - 3.5 Si dhe shpenzimet e tjera të nevojshme që ka ndërmarrja për ofrimin e këtij shërbimi.
4. Tarifat e parkimit duhet të jenë të publikuara në mënyrë të dukshme në vendparkime dhe në faqen zyrtare të Ndërmarrjes, në mënyrë që shfrytëzuesit të jenë të informuar për detyrimet e tyre financiare.

Neni 12

Mënyra e pagesës

1. Pagesa e parkimit mund të kryhet në këto forma:
 - 1.1 Me para të gatshme tek inkasanti;
 - 1.2 Përmes automatëve të parkimit (Me monedha apo me kartelë bankare);
 - 1.3 Përmes xhirollogarisë bankare të ndërmarrjes;
 - 1.4 Si dhe përmes formave të tjera të cilat Ndërmarrja, me kalimin e kohës, i përcakton si më të përshtatshme për inkasimin e mjeteve.
2. Dëshmia e pagesës mund të verifikohet si në vijim:
 - 2.1 Në rastet e pagesës me biletë fizike, shfrytëzuesi është i obliguar ta vendosë atë në pjesën e brendshme të xhamit të përparmë (mbrojtësin e erës), në mënyrë që kontrollori të mund të kryejë verifikimin e vlefshmërisë së saj.
 - 2.2 Në rastet e pagesave të kryera në mënyrë elektronike, shfrytëzuesi nuk ka obligim të vendosë biletën fizike, pasi verifikimi kryhet nga kontrollori përmes targës së automjetit në sistemin elektronik të Ndërmarrjes.

Neni 13

Shitja e biletave të parkimit përmes automatëve të parkimit

1. Bileta e parkimit e cila merret nga automati përmban të dhënat themelore, siç janë: emërtimi i rrugës, zona, numri i automatit dhe i biletës, data, koha e fillimit të parkimit dhe koha deri kur vlen bileta e parkimit.
2. Në çdo automat të parkimit gjenden udhëzimet për shfrytëzimin e automateve të parkimit, në të cilët tregohet koha dhe çmimi i parkimit, emri i rrugës, numri i zonës së automatit. Automatët bashkëkohorë të parkimit mundësojnë blerjen e biletave të parkimit përmes monedhave, kartëmonedhave, kartelave kreditore.
3. Në rast se automati ka defekt teknik dhe nuk lëshon biletën pas pagesës, ose bën llogaritje të gabuar, shfrytëzuesi ka të drejtë të kontaktojë qendrën e thirrjeve të shënuar në automat për të evituar dënimin, ose të kërkojë rimbursim nga Ndërmarrja.
4. Kjo është një nga mënyrat e pagesës.

Neni 14

Biletat e rregullta të parkimit orëshe dhe ditore

1. Shfrytëzuesit e vendparkimeve në nën-zonat e cekura në nenin 6, kanë mundësi të paguajnë shërbimin bazuar në kohëzgjatje (orëshe) ose si biletë ditore (prepagim).
2. Për parkimet e mbyllura me laurë (Pagesa në dalje) nëse kohëzgjatja e parkimit tejkalon 120 minuta, sistemi e llogarit pagesën sipas tarifës së përcaktuar për biletën ditore (çmim fiks), në përputhje me çmimet e miratuara në Shtojcën e kësaj Rregulloreje.
3. Për parkimet në rrugë:
 - 3.1 Shfrytëzuesi është i obliguar të kryejë pagesën menjëherë në fillim të shfrytëzimit të vendparkimit, duke blerë biletën orëshe ose biletën ditore, sipas zgjedhjes së tij.
 - 3.2 Pagesa e kryer në fillim është e detyrueshme dhe nuk mund të konvertohet automatikisht nga tarifë orëshe në biletë ditore, përveç në rastet kur shfrytëzuesi e ka blerë paraprakisht biletën ditore.
 - 3.3 Në rast se kontrollori konstaton që automjeti po shfrytëzon vendparkimin me biletë të skaduar, shfrytëzuesit nuk i njihet më e drejta për të paguar çmimin e biletës ditore, por do të aplikohet ekskluzivisht Tarifa Shtesë në përputhje me Nenin 24.
4. Çdo dalje nga vendparkimi konsiderohet përfundim i vlefshmërisë së biletës së paguar, pavarësisht kohës së mbetur të saj.
5. Në rast se shfrytëzuesi dëshiron të hyjë përsëri në të njëjtën ditë në të njëjtin vendparkim, ai është i obliguar të blejë një biletë të re, sipas tarifave të përcaktuara në këtë Rregullore.
6. Bileta ditore është e vlefshme vetëm për një hyrje të vetme dhe për përdorim të pandërprerë të vendparkimit deri në përfundim të ditës kalendarike.
7. Dalja nga vendparkimi para përfundimit të biletës ditore e bën biletën ditore të pavlefshme për rihyrje, pa të drejtë kompensimi apo transferimi të saj.

Neni 15

Biletat vjetore të parkimit

1. Shfrytëzimi i përhershëm i vendparkimeve u referohet dy (2) kategorive të shfrytëzuesve dhe me prioritet, sipas renditjes në vijim:
 - 1.1 Banorët të cilët jetojnë në rrugën ku parkimi paguhet (rezident);
 - 1.2 Bizneset apo OJQ-të të cilët e kanë selinë e vetë në rrugën ku parkimi paguhet, vetëm për veturat e tyre zyrtare;
2. E drejta për parkim të përhershëm (të rezervuar) fitohet vetëm pas nënshkrimit të Kontratës për shfrytëzim me ndërmarrjen dhe pagesës së abonimit. Kohëzgjatja e kontratës është zakonisht 1 (një) vjeçare, me mundësi vazhdimi.
3. Në zonat e destinuara për banorë rezidentë, nëse banorët nuk shprehin interesim ose nuk lidhin kontratë me Ndërmarrjen, hapësirat e papaguara humbin statusin e “rezervimit”. Në këto raste, Ndërmarrja ruan të drejtën t’i ofrojë ato hapësira për shfrytëzuesit e tjerë si vendparkime të kohëpaskohshme (me pagesë orëshe) për të siguruar shfrytëzimin efikas të pronës publike.
4. Në rastet kur vendparkimet e destinuara për banorët rezidentë dhe personat juridikë shfrytëzohen në mënyrë të pautorizuar, punëtorët e ndërmarrjes janë të obliguar të njoftojnë Inspektoratin Komunal dhe Policinë për largimin e automjetit.

Neni 16

Obligimet e shfrytëzuesit

1. Parkimi i automjetit në hapësirat e shënuara si vendparkime me pagesë përbën veprim konkludent. Përmes këtij veprimi, shfrytëzuesi konsiderohet se ka pranuar pa rezerva Kushtet e Përgjithshme të kësaj Rregulloreje, si dhe detyrimin për shlyerjen e tarifave të aplikueshme.
2. Shfrytëzuesi ngarkohet me këto detyrime:
 - 2.1 Të kryejë pagesën menjëherë pas parkimit, sipas metodave të përcaktuara në Nenin 12.
 - 2.2 Të afishojë biletën fizike në mënyrë të dukshme në xhamin e përparmë (kroskot), duke siguruar që të gjitha të dhënat të jenë lehtësisht të lexueshme nga jashtë për qëllime inspektimi (me përjashtim të rasteve kur pagesa kryhet përmes kanaleve elektronike).
 - 2.3 Të respektojë afatin kohor të qëndrimit në përputhje me kohëzgjatjen e përcaktuar në biletën e paguar.
3. Në rastet kur bileta fizike nuk është e afishuar në mënyrë të rregullt (është vendosur mbrapsht, ka rënë nga pozicioni i dukshëm, ose është e dëmtuar/palexueshme), barra e provës për vërtetimin e pagesës bie mbi shfrytëzuesin. Në këto rrethana, zyrtari kontrollues gëzon të drejtën të aplikojë Tarifën Shtesë për mungesë të dëshmisë së pagesës.
4. Shfrytëzuesi detyrohet të pozicionojë automjetin rreptësisht brenda vijëzimeve të përcaktuara të vendparkimit. Okupimi i më shumë se një vendparkimi (zënia e dy apo më shumë hapësirave) e ngarkon shfrytëzuesin me detyrimin për pagesën e tarifës shtesë për secilën hapësirë të zënë.

5. Para lëshimit të njoftimit për Tarifë Shtesë, zyrtari kontrollues ka detyrimin të verifikojë në sistemet elektronike nëse pagesa për automjetin përkatës është kryer përmes metodave alternative (llogari bankare, pagesë digjitale, etj.), me përjashtim të rastit në paragrafin 4.

Neni 17

Lirimi nga pagesa e vendparkimit

1. Nga detyrimi për pagesën e tarifës së parkimit përjashtohen kategoritë e mëposhtme:
 - 1.1 Personat me aftësi të kufizuara: Të cilët janë pajisur me “Kartelën e Parkimit për Personat me Aftësi të Kufizuara”, të lëshuar nga organi kompetent (Ministria përkatëse ose Komuna), në përputhje me legjislacionin në fuqi. E drejta e lirimit nga pagesa ushtrohet në vendparkimet e shënuara dhe të rezervuara posaçërisht për këtë kategori.
 - 1.2 Për Automjetet e Shërbimeve të Urgjencës dhe inspektimit lirimi vlen vetëm gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare ose ndërhyrjeve emergjente për automjetet e mëposhtme:
 - 1.2.1 Autoambulancat;
 - 1.2.2 Automjetet e zjarrfikësve;
 - 1.2.3 Automjetet e Policisë së Kosovës;
 - 1.2.4 Automjetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK);
 - 1.2.5 Automjetet e inspektoratit komunal (gjatë inspektimit në terren).
2. Për të gëzuar të drejtën e lirimit sipas pikës 1.1 të këtij Neni, shfrytëzuesi detyrohet të përmbushë kushtet vijuese:
 - 2.1 Kartela identifikuese duhet të jetë origjinale dhe e vlefshme.
 - 2.2 Kartela duhet të jetë e afishuar në mënyrë të dukshme në xhamin e përparmë të automjetit, për të mundësuar verifikimin nga kontrollori.
3. Përdorimi i kopjeve të pa-noterizuara, dokumenteve të skaduar apo shenjave identifikuese të improvizuara është i pavlefshëm. Në raste të tilla, automjeti do t'i nënshtrohet Tarifës Shtesë për mungesë pagese.
4. Për të thjeshtuar procedurat e kontrollit dhe verifikimit:
 - 4.1 Personat me aftësi të kufizuara (që janë banorë rezidentë të Komunës së Vushtrisë) dhe institucionet e përcaktuara në pikën 1.2, kanë të drejtë të kërkojnë regjistrimin e targave të automjeteve të tyre në bazën e të dhënave të Ndërmarrjes (“Lista e Bardhë”).
 - 4.2 Me rastin e regjistrimit në “Listën e Bardhë”, sistemi elektronik do të njohë automatikisht statusin e automjetit, duke shmangur detyrimin për afishimin fizik të dëshmisë së lirimit në xhamin e automjetit.

KREU V

Kontrolli i shfrytëzimit të vendparkimeve publike dhe ndalesat

Neni 18

Kontrolli i shfrytëzimit të vendparkimeve publike

1. Kontrollin e pagesës dhe shfrytëzimit të vendparkimeve e kontrollorët e ndërmarrjes.
2. Gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, Kontrollorët janë të detyruar:
 - 2.1 Të jenë të pajisur me uniformën zyrtare të Ndërmarrjes.
 - 2.2 Të mbajnë në mënyrë të dukshme kartën zyrtare të identifikimit (ID) të lëshuar nga Ndërmarrja.
3. Në çdo rast kur konstatohet se shfrytëzuesi nuk ka kryer pagesën, ose e përdor hapësirën në kundërshtim me destinimin e saj, ndërmarrja zbaton masat administrative përcaktuara në Nenin 19 të kësaj Rregulloreje.
4. Shfrytëzuesi ngarkohet me detyrimin për të paguar “Tarifën Shtesë” (Faturë me vlerë të rritur për shkelje kontraktuale), në rastet vijuese:
 - 4.1 Mospagesa e biletës së parkimit;
 - 4.2 Tejkalimi i kohës së qëndrimit të paguar (pas përfundimit të tolerancës);
 - 4.3 Uzurpimi i vendparkimeve të rezervuara për banorët rezidentë, subjekteve afariste apo OJQ-ve;
 - 4.4 Shfrytëzimi i vendparkimit në kundërshtim me rregullat specifike të zonës përkatëse.
5. Në rastet kur automjeti është parkuar në mënyrë të parregullt dhe:
 - 5.1 Pengon hyrje-daljet e objekteve ose vendparkimeve publike;
 - 5.2 Uzurpon vendparkimet e dedikuara për Personat me Aftësi të Kufizuara;
 - 5.3 Pengon rrjedhën normale të trafikut rrugor;
6. Ndërmarrja njofton menjëherë Inspektoratin Komunal ose Policinë e Kosovës për iniciimin e procedurës së largimit të automjetit me mjet special transportues (Merimangë). Shpenzimet e largimit barten nga shfrytëzuesi.
7. Konstatimi i shkeljes dokumentohet detyrimisht përmes fotografimit digjital. Fotografia shërben si provë materiale dhe duhet të përmbajë qartësisht:
 - 7.1 Targën e automjetit;
 - 7.2 Xhamin e përparmë (kroskotin) për të dëshmuar mungesën e biletës fizike;
 - 7.3 Kohën e saktë të konstatimit (datën, orën dhe minutën - *timestamp*).
8. Pas skadimit të biletës së paguar, shfrytëzuesi ka një periudhë tolerance prej pesëmbëdhjetë (15) minutash para se të lëshohet tarifa shtesë.

Neni 19

Shfrytëzimi jo i duhur i vendparkimeve

1. Çdo shfrytëzues i cili përdor hapësirën e parkimit në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje (mungesa e biletës, tejkalimi i kohës, ose parkimi në zona të palejuara sipas zonimit të Ndërmarrjes), konsiderohet se ka shkelur Kushtet e Përgjithshme. Kjo shkelje sjell automatikisht detyrimin për pagesën e Tarifës Shtesë.

2. Fatura e Tarifës Shtesë e lëshuar nga kontrollorët e autorizuar të Ndërmarrjes nuk përfaqëson sanksion administrativ (gjobë kundërvajtëse), por përbën një detyrim civil-kontraktual (penalitet) për shfrytëzimin e parregullt të pronës/hapësirës së menaxhuar nga Ndërmarrja.
3. Lartësia monetare e Tarifës Shtesë është e përcaktuar në mënyrë taksative në Nenin 24 të kësaj Rregulloreje.
4. Shfrytëzuesi detyrohet të shlyejë Tarifën Shtesë brenda një afati prej tetë (8) ditësh kalendarike nga data e lëshimit të njoftimit/faturës.
5. Në rast të mospagesës brenda afatit të përcaktuar në par. 4:
 - 5.1 Fatura e papaguar konsiderohet dokument i besueshëm për iniciimin e procedurës së arkëtimit të detyrueshëm.
 - 5.2 Ndërmarrja inicion procedurën ligjore pranë Përmbauesit Privat, konform Nenit 20 të kësaj Rregulloreje dhe Ligjit për Procedurën Përmbaimore.
 - 5.3 Përveç borxhit kryesor, shfrytëzuesi do të ngarkohet edhe me të gjitha shpenzimet procedurale përmbaimore me përjashtim të kamatës ligjore që nuk zbatohet tek personat fizik/klientët.
6. Aplikimi i Tarifës Shtesë nga Ndërmarrja nuk përjashton përgjegjësinë administrative të shfrytëzuesit. Në rastet kur parkimi i parregullt përbën rrezikim të trafikut ose shkelje të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor:
 - 6.1 Ndërmarrja njofton organet kompetente (Policinë e Kosovës ose Inspektoratin).
 - 6.2 Shfrytëzuesi mund të dënohet me gjobë kundërvajtëse nga organet shtetërore, paralelisht dhe pavarësisht nga detyrimi civil ndaj Ndërmarrjes.

Neni 20

Përmbaimi i detyrueshëm

1. Në rast se shfrytëzuesi nuk përmbush detyrimin për pagesën e Tarifës Shtesë brenda afatit prekluziv të përcaktuar në Nenin 19 par. 4, Ndërmarrja, në cilësinë e Kreditorit, inicion pa vonesë procedurën për arkëtimin e detyrueshëm të borxhit.
2. Procedura e ekzekutimit të detyrueshëm realizohet përmes Përmbauesit Privat kompetent pas dorëzimit të propozimit për përmbaim tek Oda e Përmbauesve Privat, në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbaimore (LPP) në fuqi.
3. Për qëllime të caktimit të përmbaimit, ekstrakti nga librat financiarë të Ndërmarrjes, faturat e papaguara, së bashku me dëshmitë materiale nga sistemi elektronik (fotografi, data, koha dhe lokacioni), konsiderohen **“Dokument i Besueshëm”** në kuptim të Nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbaimore.

Neni 21

Ndalesa e parkimit

1. Ndalohet rreptësisht parkimi ose lënia e automjetit në hapësirat e menaxhuara nga Ndërmarrja në rastet vijuese:
 - 1.1 Parkimin e veturës në hapësirat e parkimit për personat me aftësi të kufizuara.
 - 1.2 Në vendparkimet e rezervuara ekskluzivisht për banorët rezidentë.
 - 1.3 Në vendparkimet e rezervuara për subjektet afariste (bizneset) apo OJQ-të.
 - 1.4 Vazhdimi i qëndrimit në vendparkim pas skadimit të kohës për të cilën është kryer pagesa (tejkalimi i afatit).
2. Për çdo shkelje të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, ndaj shfrytëzuesit aplikohen masat dhe sanksionet financiare (Tarifa Shtesë) sipas procedurës së paraparë në Nenin 19 të kësaj Rregulloreje.
3. Përveç aplikimit të Tarifës Shtesë, në rastet e shkeljeve të rënda të përcaktuara në pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 (uzurpimi i hapësirave të rezervuara), automjeti i nënshtrohet masës së zhvendosjes së detyrueshme.
4. Largimi i mjetit bëhet me mjet special transportues (Merimangë), në mbështetje të Nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor. 3Të gjitha shpenzimet e zhvendosjes dhe ruajtjes së automjetit barten nga shfrytëzuesi.

Neni 22

Punët në mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e kësaj rregulloreje e kryen ndërmarrja në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspeksionit në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

Neni 23

Bashkëpunimi inspeksionit komunal dhe policisë

1. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të rënda sipas Nenit 21 (uzurpimi i vendeve të rezervuara, cenim i hapësirës së Personave me Aftësi të Kufizuara, ose pengim i qarkullimit/hyrje-daljeve), Ndërmarrja njofton pa vonesë Inspektoratin Komunal dhe kërkon lëshimin e urdhrin për largimin e automjetit.
2. Inspektori Komunal, pas daljes në vendngjarje dhe verifikimit të gjendjes faktike (e cila dokumentohet përmes fotografimit), nxjerr Aktvendim të menjëhershëm për zhvendosjen e automjetit.
3. Vendimi për zhvendosje (në formë të njoftimit/tiketes) vendoset në xhamin e automjetit. Me këtë veprim, pala konsiderohet e njoftuar ligjërisht.
4. Ekzekutimi fizik i vendimit për zhvendosje realizohet nga Ndërmarrja përmes automjetit special transportues (Merimangë). Procesi kryhet nën mbikëqyrjen e Inspektorit dhe në koordinim të detyrueshëm me Policinë e Kosovës (pëlqimi/asistenca policore), konform nenit 5 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor.

5. Automjeti i zhvendosur lirohet nga qendra ku mbahet vetëm pasi pronari të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare, ose pasi të ketë nënshkruar marrëveshje me Ndërmarrjen për pagesën e borxhit (që shërben si titull ekzekutiv).
6. Inspektori autorizon ndërprerjen e veprimit të zhvendosjes vetëm nëse pronari/shfrytëzuesi paraqitet në vendngjarje para se automjeti të jetë ngritur/ngarkuar plotësisht në mjetin transportues. Në këtë rast, shfrytëzuesi detyrohet të paguajë në vend (ose të pranojë faturën për):
 - 6.1 Tarifën Shtesë.
 - 6.2 Tarifën për “Tentim - Zhvendosje” në vlerë prej 50% të kostos së plotë të Merimangës.
7. Inspektorati Komunal ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme për të garantuar se parkingjet publike shfrytëzohen në harmoni me destinimin e përcaktuar në këtë Rregullore dhe ka autoritetin të urdhërojë mënjanimin e çdo parregullsie brenda afateve të caktuara.
8. Gjatë periudhës që automjeti qëndron i bllokuar ose në pritje të zhvendosjes (sipas par. 2 të këtij neni), shfrytëzuesi ngarkohet edhe me tarifën e rregullt të shfrytëzimit të vendparkimit, krahas sanksioneve të tjera.
9. Ndërmarrja ka për detyrë të mbajë të informuar Inspektoratin Komunal për të gjitha veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij Neni dhe Nenit 19 par. 6.

KREU VI

DETYRIMET FINANCIARE (TARIFAT SHITESË) DHE MASAT NDËSHKUESE

Neni 24

Detyrimet Financiare (Tarifat Shtesë) dhe Dispozitat ndëshkuese

1. Për përdorimin e hapësirave të parkimit në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, ndërmarrja aplikon Tarifat Shtesë (Faturë me vlerë të rritur për shkelje kontraktuale), siç përcaktohet më poshtë:
 - 1.1 Për parkim pa kryer pagesën, ose për mos-afishimin e biletës në mënyrë të dukshme (sipas Nenit 16): Tarifë Shtesë: **20.00 Euro**.
 - 1.2 Për tejkalim të kohës së paguar: Tarifë Shtesë në vlerë prej **20.00 Euro**.
2. Nëse shfrytëzuesi e kryen pagesën e Tarifës Shtesë brenda afatit prej 48 orëve nga momenti i lëshimit të njoftimit, ai përfiton automatikisht një zbritje prej 50% të vlerës së tarifës. Pas kalimit të këtij afati, tarifa duhet të paguhet në vlerën e saj të plotë (100%).
3. Përveç tarifave të Ndërmarrjes, për shkeljet që bien ndesh me Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor, aplikohen gjobat nga organet kompetente:
 - 3.1 Gjoka kundërvajtëse shqiptohet nga Policia e Kosovës ose Inspektorati Komunal, në vlerën e përcaktuar me Ligjin në fuqi.
 - 3.2 Për bllokimin e hyrjes së vend parkimit, zbatohen procedurat e largimit të automjetit sipas Nenit 23 të kësaj Rregulloreje.

KREU VII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25

1. Ndërmarrja dhe personeli i saj nuk ushtrojnë kompetenca policore apo administrative shtetërore. Ndalohet çdo formë e bllokimit fizik arbitrar, konfiskimit të veturave ose përdorimit të forcës nga ana e punonjësve të Ndërmarrjes pa bazë ligjore të shprehur.
2. Në rastet kur paraqitet nevoja për largimin e automjetit (zhvendosje me mjet special) ose bllokim për shkaqe sigurie dhe uzurpimi:
 - 2.1 Personeli i Ndërmarrjes ka vetëm rol iniciues, duke i drejtuar kërkesë zyrtare Inspektoratit Komunal ose Policisë së Kosovës.
 - 2.2 Urdhri ekzekutiv për bllokim ose zhvendosje jepet ekskluzivisht nga personi zyrtar kompetent (Inspektori Komunal ose Zyrtari Policor), konform legjislacionit në fuqi. Urdhri për bllokim/zhvendosje jepet ekskluzivisht nga personi zyrtar (Inspektori/Polici).
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon së vlefshmi (shfuqizohet) Rregullorja Nr. 02/2016 për Menaxhimin e Parkingjeve Publike në Komunën e Vushtrrisë, si dhe çdo akt tjetër nënligjor komunal që bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
4. Shfuqizohen në mënyrë specifike neni 9 i Rregullores Nr. **286/23** për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**Kryesuesi/ja i/e Kuvendit
Komunal të Komunës së
Vushtrrisë**